

VENDIM
Nr.252, datë 13.4.2010

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT
E NJERIUT, DATË 13.11.2007 PËR ÇËSHTJEN NR.38222/02 “RRAMADHI DHE TË
TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës europiane për të drejtat e njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 13.11.2007 për çështjen nr.38222/02 “Rramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për shumën 120 000 (njëqind e njëzet mijë) euro, si dhe për pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin, në masën 10 për qind të kësaj shume.

2. Interesi, që paguhet mbi këtë shumë, llogaritet nga data 13 gusht 2008 dhe është i barabartë me normën marzhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 (tre) për qind.

3. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim është data 15.4.2010.

4. Detyrimi financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

5. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi të depozitohet në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve Shyqyri Rramadhi, Remzi Kapidani dhe Rabije Rramadhi, dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së llogarisë.

6. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 4 të këtij vendimi në favor të ankuesve Shyqyri Rramadhi, Remzi Kapidani dhe Rabije Rramadhi, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha